



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

01-2240



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 44, 45, 57 & 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-03, dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrative të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe bazuar në Vendimin Nr.A-279/22 dt.22.02.2022 të MMPHI-së, Departamenti Ligjor i MMPH-së, për rishqyrtimin e Vendimit 05nr.350/02 – 1228602/20 dt.10.10.2022 mbi refuzimin e kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02–228602/20 dt.14.12.2020, të kërkuesve: Pronarëve, Basri, Enver, Avni dhe Mensur Pllana, Fikret Thaçi, Ahmet Gashi nga Prishtina rr."Rrustem Statovci" nr.165,167 & 169, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin ndërtesës shumë banesore & afariste – **Ndërtesa** me 3B+S+P+8, në kuadër të Zona ndërtimore "L" të Planit Rregullues "Dodona" dhe PZHU, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rishqyrtimit të kërkesës për kushte ndërtimore, me datë 16.10.2024, merr këtë:

V E N D I M

CAKTIM I KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore, kërkuesve: Pronarëve, Basri, Enver, Avni dhe Mensur Pllana, Fikret Thaçi, Ahmet Gashi nga Prishtina rr."Rrustem Statovci" nr.165, 167 & 169, sipas kërkesës 05nr.350/02–228602/20 dt.14.12.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – **Ndërtesa** me 3B+S+P+8 në kuadër të Zona ndërtimore "L" të Planit Rregullues "Dodona" dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.6902-1, 6902-2, 6902-3, 6902-4 & 6902-5 ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit konceptual dhe "zgjidhja urbane" të prezantuar.

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore përfshihet në kuadër të Planit Rregullues "Dodona" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës 01 nr.35 -18190 dt.03.08.2005, ku sipas këtij plani kjo zonë është e destinuar "*Bërthama e zonës*", si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë, 01nr.035-181427 dt. 24.09.2013, me destinim "Ndërtim i lartë";

Për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, kërkuesit janë informuar përmes sistemit Online " Informim nga Plani Rregullues "Dodona" – PZHU" me reference 2649 dt.28.01.2020 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës;

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit / parcelës, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronarët & klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, janë:
 - nr.6902-1;S=397m²;Basri,Enver,Avni & Mensur Pllana,Fikret Thaçi,Ahmet Gashi;....."Tokë ndërtimore";
 - nr.6902-2;S=141m²;Basri,Enver,Avni & Mensur Pllana,Fikret Thaçi,Ahmet Gashi;.."Pemishte e klasit 3";
 - nr.6902-3;S=134m²;Basri,Enver,Avni & Mensur Pllana,Fikret Thaçi,Ahmet Gashi;.."Pemishte e klasit 3";
 - nr.6902-4;S=116m²;Basri,Enver,Avni & Mensur Pllana,Fikret Thaçi,Ahmet Gashi;.."Pemishte e klasit 3";
 - nr.6902-5;S=232m²;Basri,Enver,Avni & Mensur Pllana,Fikret Thaçi,Ahmet Gashi;....."Tokë jopjellore";

Totali: S=1,020m².

- Parcela kadastrale janë në pronësi të pronarëve privat, bazuar në si dhe e njëjta ka kyçje në infrastrukturë teknike rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrikë dhe telefoni;

- Në kuadër të parcelës përfshihet / shtrihet ndërtesa individuale banimore me etazhitet nga P+1 deri në P+1+Nk ;
- Terreni i lokacionit, është i pjerrët me ramje-disnivel në drejtimin lindje – perëndim me ~6.8m’;
- Në diametër prej 50m’ të lokacionit, përfshihen kryesisht ndërtesa individuale banimore, si dhe një ndërtesë shumë banesore dhe afariste;
- Parcela kadastrale e lartcekur, kufizohen dhe kanë qasje nga rrugët “Rrustem Statovci”, e cila rrugë është edhe e planifikuar me planin rregullues urban, si dhe në pjesën veriore kufizohen me “Parku i qytetit”;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për realizimin, ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste, si dhe hapësirat përcjellëse, në kuadër të parcelës ndërtimore të Zona ndërtimore “L” të Planit Rregullues “Dodona” në Prishtinë dhe PZHU-së, bazuar në kriteret & parametrat urban, dhe janë:

- Organizimi, gabariti, pozicionimi, etazhiteti i ndërtesës dhe raporti i sajë me distanca nga kufiri i parcelave, rrugët e planifikuara, parcela ndërtimore e bllokut urban, si dhe kushtet tjera, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane”, bashkëngjitur vendimit të kushteve ndërtimore;

- Parcela kadastrale, me sipërfaqen të trajtuara, për realizimin e ndërtesës shumë banesore & afariste, konkretisht parcela ndërtimore të përfshira – brenda vijës rregulluese, janë:

- nr.6902-1; S=326m²;
 - nr.6902-2; S=112m²;
 - nr.6902-3; S=107m²;
 - nr.6902-4; S=92m²;
 - nr.6902-5; S=194m²;
- Totali: S=831m².**

- Parcela kadastrale me sipërfaqe të trajtuara, për realizimin e shumë banesore & afariste, që shtrihen në hapësira publike të planifikuara, konkretisht që shtrihen jashtë vijës rregulluese, janë:

- nr.6902-1; S=71m²;
 - nr.6902-2; S=29m²;
 - nr.6902-3; S=27m²;
 - nr.6902-4; S=24m²;
 - nr.6902-5; S=38m²;
- Totali: S=189m².**

- Me kushtet ndërtimore në kuadër të kompleksit planifikohet ndërtimi i ndërtesës shumë banesore & afariste, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet (sipas projekt propozimit konceptual):

Ndërtesa shumë banesore & afariste,

S=5,110.99m² / 3,060m², mbi tokë + 2,050.99m², nën tokë /,

Etazhitet: 3B+S+P+8,

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës të jetë "Ndërtim i lartë mix.", gjegjësisht afarizëm & banim shumë banesor, si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, dhe hapësira garazheve, etj. (sipas projekt propozimit të prezantuar);

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave kadastrale / parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi parcelave brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazën - gabaritin e përdheses ose suteranit, lejohet max.40%. Sipas llogarive dhe projekt propozimit, kjo sipërfaqe është: S=831 x 0.4=332.40m² / lejuar sipas PZHU-së /, S=332.40m² / sipas projekt propozimit konceptual /.

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave kadastrale / parcelën ndërtimore (ISHPN), konkretisht shfrytëzimi e parcelave brenda vijës rregulluese, bazuar në Vendimit 01nr.031-185481 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin të bodrumit lejohet max.60%, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është: S=831 x 0.6=498.60m²; / lejuar sipas vendimit / S=498m² / sipas projekt propozimit konceptual /

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISHPGJ) bazuar në planin rregullues dhe në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01nr.031-185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3

(30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, kjo sipërfaqe është

$S=831 \times 0.4=332.40\text{m}^2$; / sipas vendimit /

$S=267 + 120=387\text{m}^2$ /sipas projekt propozimit konceptual /

• Koeficienti i ndërtimit (ISHN) bazuar në sipërfaqen e parcelës ndërtimore miratohet, **3.0** përcaktuar me koeficientin minimal të PZHU-së. Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:

$S=831 \times 3.0=2,493\text{m}^2$ / sipas PZHU-së /,

$S=3,060\text{m}^2$ / sipas projekt propozimit konceptual dhe miratuar /.

• Me aplikimin e Vendimi 14nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për shpronësimin/kompensimin e pronës private të planifikuar për interes publik me koeficient të ndërtimit, sipërfaqja e parcelës jashtë vijës rregulluese, mund të kompensohet deri 20%. Në këtë rast sipërfaqja jashtë vijës rregulluese është $S=189\text{m}^2$, e cila sipërfaqe në raport me parcelën ndërtimore është $S=189 / 831 \times 100=22.84\%$. Sipas kësaj sipërfaqja prej 20% do të trajtohet bazuar në Vendimin 14nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022, dhe kjo sipërfaqe do të jetë $S=831 \times 0.2=166.20\text{m}^2$, e cila kalkuluar me koeficientin e ndërtimit do të është, $S=166.20 \times 3.0=498.60\text{m}^2$. Ndërsa, sipërfaqja e mbetur prej $S=189-166.20=22.80\text{m}^2$, do të trajtohet me koeficientin minimal të PZHU-së, bazuar në Vendimi 01nr.031 – 185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, e që gjithashtu është 3.0, andaj bazuar në kalkulimin do të jetë: $S=22.80 \times 3.0=68.40\text{m}^2$.

Andaj, sipas vendimit të lartcekur mund të shpronësohet / kompensohet me sipërfaqe ndërtimore e tëra edhe në këtë rast kompensimi është, $S=189 \times 3.0=567\text{m}^2$.

Bazuar në kalkulimet, totali i lejuar për ndërtim do të jetë: **$S=2,493 + 498.60 + 68.40=3,060\text{m}^2$** ;

• Bazuar në kriteret e planit rregullues, sipërfaqja e lirë në fasada me hapje primare (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj.) është $0.25 \times H$. Përmes pëlqimit të vërtetuar distanca mund të zvogëlohet apo edhe ndërtohet në kufi të parcelës ndërtimor / kadastrale;

• Etazhiteti maksimal i lejuar në zonën ndërtimore "L" sipas Planit Rregullues "Dodona" në Prishtinë është $\text{II} \div \text{IV}$, kurse sipas PZHU-së $\text{X} \div \text{XV}$. Etazhiteti mund të ndryshojë nëse aplikohet Vendimi 14nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin me koeficient të ndërtimit të pronës private për interes publik;

• Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015, protokolluar me numrin 01nr.031-185481, për arsye të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit" në fasadat e ndërtesës, nuk do të përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISHN), e as në kalkulimin për taksën dhe tarifën e lejes ndërtimore;

• Ngritja e nivelit të përdhësës së ndërtesës nga niveli i terrenit - trotuarit, të jetë për afarizëm max.30cm, kurse për pjesën e banimit max.1.20m';

• Dalja me konzollë në ndërtesë nuk lejohet;

• Qasja në ndërtesë të jetë nga rruga "Rrustem Statovci" e cila është edhe rrugë e planifikuar të planit rregullues urban;

• Në kuadër të ndërtesës të parashihen edhe vend parkimet brenda ndërtesës, shtigjet;

• Për çdo njësi banesore të planifikohet një vendparkim;

• Në kuadër te kompleksit të planifikohen hapësira-pika për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;

• Arkitektura - dukja e jashtme (fasada) e ndërtesës dhe materializimi i ndërtesës të jetë me materiale bashkëkohore dhe masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

• Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuar në kriteret dhe parametrat urban të Plani Rregullues "Dodona".

V. Ndarja / parcelimi i parcelave kadastrale nr.6902-1, 6902-2, 6902-3, 6902-4 & 6902-5 ZK Prishtinë, do të realizohet bazuar në kriteret e planit rregullues dhe sipas Manualit të ndarjes punuar nga geometri i licencuar Veton Kutllovci nga Prishtina, me licencë nr.26.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi jep PËLQIM për ndarjen e parcelave të lartcekura, sipas manualit të ndarjes. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar

në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura të zhvillohet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronari, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori, dhe Manuali i ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar Valmir Latifi nga Vitia, me licencë nr.180, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. Bashkimi i pjesëve të parcelave kadastrale, nr.6902-1, 6902-2, 6902-3, 6902-4 & 6902-5 ZK Prishtinë, të realizohet sipas parcelës ndërtimore dhe pas realizimit të procedurës së ndarjes të përcaktuar në paragrafin V. të këtij vendimi, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", Situacionit të parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Dodona" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KosovaREF01 dhe manuali i bashkimit punuar nga gjeometri i licencuar.

Drejtorja jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Dodona" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manualit për bashkim. Procedura e bashkimit do të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Dodona" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KosovaREF01 dhe Manualin e ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar Veton Kutlllovci nga Prishtina, me licencë nr.26, e të cilët janë pjesë përbërëse e këtij vendimi

VII. Kompensimi/shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i pjesëve të parcelave kadastrale, nr.6902-1 me $S=71m^2$, nr.6902-2 me $S=29m^2$, nr.6902-3 me $S=27m^2$, nr.6902-4 me $S=24m^2$ dhe nr.6902-5 me $S=38m^2$, dhe me sipërfaqe totale prej $S=189m^2$, të përfshirë në hapësira publike të planifikuara – rrugë, të realizohet si më poshtë;

Me aplikimin e Vendimi 14nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, sipërfaqja e parcelës jashtë vijës rregulluese - parcelës ndërtimore mund të kompensohet deri në 20%. Sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje (%) është $\frac{S=189}{831} \times 100 = 22.40\%$, dhe bazuar në vendimin e lartcekur, mund të trajtohet sipërfaqja prej $S=831 \times 0.2 = 166.20m^2$. Andaj, sipërfaqja e lartcekur e kalkuluar me koeficient ndërtimi, përcakton sipërfaqen ndërtimore të kompensuar prej, **$S=166.20 \times 3.0=498.60m^2$** .

Bazuar në Vendimi 01nr.031 – 185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, sipërfaqja e mbetur prej $S=189 - 166.20=22.80m^2$, do të trajtohet me koeficientin minimal të PZHU-së, e që gjithashtu është 3.0, andaj bazuar në kalkulimin do të jetë: $S=22.80 \times 3.0=68.40m^2$. Andaj, sipas vendimit të lartcekur mund të shpronësohet / kompensohet me sipërfaqe ndërtimore e tëra edhe në këtë rast kompensimi është, $S=189 \times 3.0=567m^2$.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore të pjesëve të parcelave të lartë cekura. Kjo procedurë e kompensimit / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Mos zbatimi i procedurës sipas këtij paragrafit, nga pronarët & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendim të kushteve ndërtimore.

VIII. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;

• *Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;*

• *Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).*

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

IX. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit ne bashkëpronësi", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr.33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

• *Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;*

• *Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*

• *Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;*

• *Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*

• *Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;*

• *Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;*

• *Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;*

• *Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;*

• *Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;*

• *Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;*

• *Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafo stacionit;*

• *Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;*

• *Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;*

• *Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*

• *Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;*

• *Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;*

• *Elaborati i analizës së ndërtesës ekzistues me ndikimet në te nga rindërtimi i etazheve – Kati 2, 3 & Ph;*

X. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

• *Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;*

• *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*

• *Situacioni-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*

- Situacionin-"zgjdhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor- Elaborati për Leje Mjedisore Komunale dhe hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XI. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE - meqenëse parcelat kadastrale nr.6902-1, 6902-2, 6902-3, 6902-4 & 6902-5 ZK Prishtinë, bazuar në certifikatat e njësive kadastrale, janë të evidentuar me lloj të shfrytëzimit si tokë bujqësore dhe infrastrukturë, me klasë të kualitetit "Pemishte e klasit 3" & "Tokë tjetër - jo pjellore" paraprakisht kërkohet të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – "zgjdhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej **S=831m²**. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësive kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve ;

XIII. PAGESA E TAKSËS për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënimin;

XIV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimit për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

A r s y e t i m

Organi i shkallës së dytë – MMPHI / Departamenti Ligjor i MMPH-së, me Vendimin Nr.A-279/22 dt.22.02.2022, ka shfuqizuar Vendimin 05nr.350/02–1228602/20 dt.10.10.2022, të Drejtorisë së Urbanizmit, mbi refuzimin e kërkesës 05nr.350/02 – 228602/20 dt.14.12.2020, dhe ka detyruar Drejtorinë e Urbanizmit të veprojë konform dispozitave të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012 dhe PZHU-së, dhe të rishqyrtoj kërkesën për kushte ndërtimore të kërkuesve: Pronarëve, Basri, Enver, Avni dhe Mensur Pllana, Fikret Thaçi, Ahmet Gashi nga Prishtina rr."Rrustem Statovci" nr.165, 167 dhe 169, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – Ndërtesa 3B+S+P+8,në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore;

Me kërkesën për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 228602/20 dt.14.12.2020, si dhe gjatë fazës së trajtimit të kërkesave, kërkuesit kanë prezantuar dhe është trajtuar ky dokumentacion:

- *Dëshmia e pronësisë për parcelën kadastrale: Kopjet e planit dhe Certifikata e njësisë kadastrale për parcelën kadastrale nr.6902-1, 6902-2, 6902-3, 6902-4 & 6902-5 ZK Prishtinë, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor Mensur Pllana, nr.163253/20 dt.11.09.2020;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor Basri Pllana, nr.163253/20 dt.11.09.2020;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor Avni Pllana, nr.163253/20 dt.11.09.2020;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor Enver Pllana, nr.163253/20 dt.11.09.2020;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor Sabit Gashi, nr.10-430/03-0161673/20 dt.09.09.2020;*
- *Foto e lokacioni;*
- *Shkresa "Informim nga Plani Rregullues Dodona – PZHU" me referencë nr.2649 dt.28.01.2020 lëshuar nga DPSZHQ të Komunës së Prishtinës;*
- *Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pronarëve;*
- *Incizimi gjeodezik i lokacionit, punuar nga gjeodeti i licencuar Veton Kutllovci nga Prishtina, me licencë nr.26;*
- *Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave punuar nga gjeodeti i licencuar Veton Kutllovci nga Prishtina, me licencë nr.26;*
- *Projekt propozimi konceptual hartuar nga "Coopertion Architecture"sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK nr.810824096;*
- *Fotot e njoftimit publik;*
- *Afishja "Njoftim publik" e datave 16.02.2021 gjerë 02.03.2021, lëshuar nga kjo drejtori;*

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 228602/20 dt.14.12.2020, dokumentacionin e prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për atë zonë, si dhe rregullativën ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumenteve të prezantuara gjatë fazës së trajtimit të kërkesës administrative, në mënyrë kronologjike konstatoi se:

Kjo drejtori, pas pranimit të kërkesës, 05nr.350/02–228602/20 dt.14.12.2020, analizimit të projekt propozimit konceptual dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, dhe dokumentet e planifikimit hapësinor për atë zonë (planin rregullues urban dhe PZHU-në), si dhe shkresa "Informim nga Plani Rregullues Dodona – PZHU" me referencë nr.2649 dt.28.01.2020, lëshuar nga DPSZHQ të Komunës së Prishtinës, ka konstatuar se në kuadër të këtyre parcelave, lejohet ndërtimi, andaj kjo drejtori, pas pranimit të kërkesës në fazën fillestare të saj, në mbështetje të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit, Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", me datë 16.02.2021, në

vende të dukshme të rrethinës dhe lokacionit, ka vendosur Afishen “Njoftimi publik” e cila ka qëndruar gjer me datë 02.03.2021, me të cilën para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës është synuar të informohet me kërkesën e aplikuesve dhe të njëjtëve i është ofruar mundësia për dhënie e komenteve, gjegjësisht pronarëve / poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m'. Gjatë kësaj periudhe në adresën e postës elektronike të vendosur në afishe nuk ka arritur ndonjë koment, andaj edhe kjo drejtori ka vazhduar me procedurën e trajtimit të kërkesës për kushte ndërtimore.

Bazuar në projekt propozimin konceptual dhe kriteret e dokumentit të planifikimit hapësinor për hapësirën, Planit Rregullues “Dodona” në Prishtinë, PZHU-së dhe kriteret e “Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi”, të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, si dhe akteve tjera nënligjore, konstatohet se projekt propozimi konceptual i prezantuar është në harmoni me kriteret e dokumenteve të planifikimit hapësinor. Bazuar në planin rregullues urban, Zona ndërtimore “L” përcakton vijën ndërtimore nga rruga “Rustem Statovci” dhe nga “Parku i qytetit”, dhe pozicionimi i ndërtesës është bërë në vijën ndërtimore nga rruga, kurse nga ana e parkut dhe anët anësore (nga kufiri i parcelës) është përcaktuar distanca e konsiderueshme në harmoni me kriteret e planit rregullues, min.0.25 x H. Destinimi i ndërtesës në kuadër të parcelës është planifikuar ai i planit rregullues dhe i PZHU-së, ndërtim i lartë i përzier, me shfrytëzimin e konfiguracionit të pjerrtësisë së terrenit, përmes niveleve nëntokësore (bodrum dhe suterren).

Bazuar në koeficientin ndërtimor të planit rregullues për zona “L” prej 2.4 dhe atij të PZHU-së prej 3.0 – 4.0, është miratuar koeficienti prej 3.0, pasi bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht Ligjtin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174 dt.23.08.2013, dhe praktikave të zhvilluara deri më sot, PZHU-ja i mbivendoset planit rregullues urban dhe bazuar në PZHU-në, hartohen dhe harmonizohen planet rregulluese urbane.

Andaj, nëse i referohemi sipërfaqes së parcelave prej $S=1,020m^2$, llogaritur me koeficientin e ndërtimit, konstatohet se sipërfaqja e gjithmbarshme e lejuar është $S=1020 \times 3.0=3,060m^2$, duke përfshi edhe sipërfaqen që do të kompensohet – shpronësohet me sipërfaqe ndërtimore, bazuar në Vendimet 14nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022, dhe Vendimi 01nr.031 – 185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, pasi sipërfaqja prej $S=189m^2$ e tejkalon 20% e parcelës ndërtimore prej $S=831m^2$, për $S=22.80m^2$, dhe e njëjta do të trajtohet me vendimin e vitit ‘2015, bazuar në koeficientin minimal të PZHU-së, por cili koeficient është i njëjtë edhe me koeficientin e trajtuar të të gjitha parcelave.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit në kuadër të drejtorisë për komunikacion, është përcaktuar rregullsia e kyçjes në ndërtesë nga aspekti i komunikacionit, si dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje në rrugën ekzistuese - planifikuar, dhe ndër të tjera konstatohet:

Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të “Cooperation Architecture”, Basri, Enver, Avni, Mensur Pllana, Fikret Thaqi, Ahmet Gashi, në lagjen “Dodona” në Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-228602/20 dt.14.12.2020, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese “Rrustem Statovci”, e cila rrugë është e paraparë edhe me planin rregullues të lagjes “Dodona”, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e till, marrë parasysh edhe gjendjen faktike të rrugës ekzistuese në raport me zgjidhjen urbane. Rregullimi i hyrje – daljeve të automjeteve nga garazhat sipas zgjidhjes së prezantuar është paraparë të bëhet përmes funksionimit të qarkullimit me semafora. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas “Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi”, “Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës” dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugëve kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Kyçja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës së planifikuar dhe në kohën kur realizohet ajo sipas planit, si dhe të ruhet profili tërthorë i rrugës së planifikuar.

Drejtoria e Urbanizmit, në fazën e trajtimit dhe vendosjes dhe pas shqyrtimit të kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02–228602/20 dt.14.12.2020 dhe Vendimin Nr.A-279/22 dt.22.02.2022, të MMPH-së, Departamenti Ligjor i MMPH-së, dokumentacionin e prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për atë zonë, si dhe rregullativën ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumenteve të prezantuara gjatë fazës së trajtimit të kërkesës administrative, vendosi që me vendim

të caktojë kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Ndërtesës shumë banesore & afariste - Ndërtesa 3B+S+P+8 në kuadër të Zona ndërtimore "L", të Planit Rregullues "Dodona" dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.6902-1, 6902-2, 6902-3, 6902-4 & 6902-5 ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit konceptual dhe "zgjidhja urbane" të prezantuar.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit – zgjidhja urbane e Ndërtesës shumë banesore & afariste - Ndërtesa 3B+S+P+8 në kuadër të Zona ndërtimore "L", të Planit Rregullues "Dodona" dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.6902-1, 6902-2, 6902-3, 6902-4 & 6902-5 ZK Prishtinë; Situacioni i parcelave kadastrale në raport me rrugët e planifikuara, si dhe vijën ndërtimore & rregulluese nga PRRU "Dodona" në sistemin koordinativ KosovaREF 01; Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

I dërgohet: Kërkuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës, 05nr.350/03 – 228602/20 dt.14.12.2020.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Planifikim Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.350/02 – 228602/20 DT.16.10.2024,**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini

Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE
RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN
KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku.



Nënshkrimi: _____

Prishtinë: 01.03.2021

Legjenda:



Vija Rregulluese dhe Ndërtimore sipas PRRU
Parcelat Kadastrale



Porositësi:
Cooperation Architecture

Emri i Projektit:
**Objekt Afarist-Banesor
3B+S+P+8**

Studio Projektuese:



Cooperation Architecture
Studio alternative e Arkitekturës dhe Dizajnit Urban
Tel :+383 44 102 784 E-mail: cooarchitecture@gmail.com

Projektuesit:
MSc. Ark. Flamur Grajçevci

Emri i Projektit:
Projekti Ideor

Emri i Vizatimit:
Situacioni i Ngushtë

Përpjesa e Vizatimit: 1:150	Formati i fletës: A3
Data: Prishtinë, 2024	Nr. i fletës: A.3

Rr. Rrustem Statovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo




Zona kadastrale/ Cadastral zone: Prishtinë
Njësia kadastrale/ Cadastral unit: Prishtinë

Komuna e Prishtinës

Numri i lëndës : _____
Shkalla e zvoglimit/ Factor scale 1: 250

Opstina Pristina - Municipality of Prishtina



Vija Rregulluese dhe ndërtimore sipas PRRU		
Nr	Y	X
1	7513943.160	4724506.610
2	7513967.190	4724499.400
3	7513986.740	4724493.530
4	7514005.420	4724487.930

Situacioni gjeodezik për parcelën kadastrale me numër : 6902-1, 6902-5, 6902-2, 6902-3, 6902-4

Sistemi Koordinativ: KOSOVAREF 01

Legjenda

6902-1  326 m²
 71 m²

6902-5  194 m²
 38 m²

6902-0  311 m²
 80 m²

 Vija Rregulluese dhe ndërtimore sipas PRRU

Rilevoi/ Measured:
Arban Grajçevci
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ name and surname of the surveyor/company)

Nënshkrimi/ Signature:

Data e rilevimit/ The survey date:
08.04.2024